



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 11

Tiranë – E martë, 18 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 4798, datë 6.4.2017	Për shitje..... 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE
Nr. 4798, datë 6.4.2017

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, Kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Ndërmarjes së Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan.

Nr.	Emertimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1.	“Magazina Sheshi 4 Nr. 1”	Elbasan	9 163 395	7 888 735	1 274 660	3 260	1 217	02.05.2017	09.00	DDPP
2.	“Magazina Sheshi 4, Nr. 2”	Elbasan	10 010 154.16	8 692 875.16	1 317 279	3 369	1 217	02.05.2017	10.00	DDPP
3.	“Reparti i Rigjenerimit te Vajrave”	Elbasan	3 427 121	2 580 301	846 820	3 618.885	659.885	02.05.2017	11.00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
 - Mandat pagesën apo Garancinë bankare** në original që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
 - Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).
- Shënim:** Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:



1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndermarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
 2. **Mandatpagesën apo Garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave.
 3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
 4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
 5. **Deklaratë materiale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.
- Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimi të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.
- Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017